



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI PORTUAL DURRËS

Durrës, më 24/12/2024

Lenda: Sqarim per ekuivalentimin e licencave

Drejtuar:

OPERATOREVE EKONOMIK TE INTERESUAR

Sqarojmë të gjithë operatorët ekonomik të interesuar që, licenca (ose dokumentin që shërben si leje për ushtrimin e aktivitetit profesional respektiv), që disponon në vendin e origjinës, të njësuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar **NUK nënkupton ekuivalentim** sipas kërkesave të neneve 30 dhe 38 të VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" e ndryshuar, **pra operatorët ekonomik të interesuar të huaj duhet të realizojnë ekuivalentimin e licencave sipas udhëzimeve më poshtë.**

Baza ligjore për ekuivalentimin e licencës së huaj individuale ose të shoqërive të huaja në fushën e studimit e projektimit dhe/ose mbikëqyrjes e kolaudimit.

Pajisja e individëve dhe subjekteve me licencë për ushtrimin e aktivitetit në fushën e studimit e projektimit dhe mbikëqyrjes së kolaudimit të zbatimit të punimeve në ndërtim, kërkohet në bazë të neneve 30 dhe 38 të VKM nr. 943, datë 28.12.2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 759, datë 12.11.2014, "Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" dhe Rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe persona juridikë në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrje e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim".

I. Aplikim për ekuivalentimin e licencës së huaj individuale në fushën e studimit e projektimit dhe/ose mbikëqyrjes e kolaudimit

Shërbimi "Aplikim për ekuivalentimin e licencës së huaj individuale në fushën e studimit e projektimit dhe/ose mbikëqyrjes e kolaudimit" u mundëson qytetarëve të aplikojnë online për ekuivalentimin e licencës profesionale për individë që disponojnë licencë profesionale në vendin e

originës (jo Shqipëri), në lidhje me studimin e projektimit apo/edhe mbikëqyrjen e kolaudimit në ndërtim.

Dokumentacioni i nevojshëm për ekuivalentimin e licencës profesionale për individë që disponojnë licencë profesionale në vendin e origjinës (jo Shqipëri);

- a. Dokumentin e identitetit që disponon
- b. Diplomën që disponon në vendin e origjinës, të njehsuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;
- c. Licencën (ose dokumentin që shërben si leje për ushtrimin e aktivitetit profesional respektiv), që disponon në vendin e origjinës, të njehsuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;
- d. Veprimtaria e tij e kryer nga marrja e diplomës në formën e CV;
- e. Dokumentacion teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre), ku personi ka qenë bashkautor; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet, duhet të kenë patjetër të përshirë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin, apo të studios/projektuesit që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën;
- f. Vetëdeklarimin e individit, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale, ku kërkon të licencohet dhe mbi angazhimin të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e tij kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1 të lidhjes nr.6);
- g. Në rastet kur personi kërkon të pajiset edhe me licencë për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, personi duhet të përfshijë në vetëdeklarimin e mësipërm edhe pozicionin e tij, në lidhje me punësimin në shoqëri ndërtimi (është apo nuk është i punësuar në ndonjë rol në këto shoqëri, sipas formatit 6/2 të lidhjes nr.6);
- h. Dy fotografi për dokument, të individit që kërkon të licencohet (fotografi të 3 muajve të fundit);
- i. Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale.

Për individët linku i aplikimit është

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11142

II. Aplikim për ekuivalentimin e licencës së shoqërive të huaja, në studim e projektim dhe /ose mbikëqyrje e kolaudim

Shërbimi "Aplikim për ekuivalentimin e licencës së shoqërive të huaja, në studim e projektim dhe /ose mbikëqyrje e kolaudim" u mundëson subjekteve të aplikojnë online për ekuivalentimin e licencës së shoqërive të huaja që disponojnë licencë profesionale në vendin e origjinës në lidhje me studimin e projektimit apo/edhe mbikëqyrjen e kolaudimit në ndërtim.

Dokumentacioni i nevojshëm për ekuivalentimin e licencës së shoqërive të huaja, që disponojnë licencë profesionale në vendin e origjinës

- a. Subjektet duhet të jete të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, me të cilin dëshmohet, ndër të tjera, lidhja e shoqërisë së krijuar e që kërkon të licencohet, me atë të vendit të origjinës, që disponon licencë profesionale, veprimtaria dhe statusi aktiv i shoqërisë;
- b. Vetëdeklarimin e përfaqësuesit/ përfaqë-suesve ligjorë, mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë ku kërkon të licencohet, si dhe mbi angazhimin që të njohë e të zbatojë në veprimtarinë e saj kushtet teknike të projektimit dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit (sipas formatit 6/1 të lidhjes nr.6);
- c. Kontratën midis përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesit teknik, të përkthyer e të noterizuar, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit);
- d. Vetëdeklarim i drejtuesit/drejtuesve teknikë:
 - i. mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë, për të cilën është kontraktuar;
 - ii. për gjendjen në lidhje me punësimin si drejtues teknik në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit;
 - iii. për gjendjen e të qenit apo jo në marrëdhënie pune me institucionet shtetërore qendrore, vendore, të pavarura, apo persona juridikë të tjerë publik (sipas formatit 6/5 të lidhjes nr.6).
- e. Diplomën që disponon drejtuesi/drejtuesit teknikë të shoqërisë në vendin e origjinës, të njehsuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe, nga përkthyes të autorizuar;
- f. Veprimtaria e kryer nga shoqëria nga marrja e licencës në vendin e origjinës, në formën e CV;
- g. Dokumentacion teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV: vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre); certifikata vlerësimi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën ku kërkon të licencohet. Të gjitha vërtetimet dhe projektet, duhet të kenë patjetër të përshirë, adresën postare dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo të studios/projektuesit që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën.
- h. Dokumentin që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës, për pajisje me licencë profesionale.

Për rastet kur kërkohet njëkohësisht edhe licencimi individual i drejtuesit/drejtuesve teknikë, që shtohen në shoqëri, aplikimi dhe kërkesat, në dëshirë të aplikuesve, hartohen dhe dërgohen bashkërisht, pa mbivendosur apo dubluar dokumentet e kërkuara për të dy aplikimet, sipas kësaj rregulloreje

Për shoqërite linku i aplikimit është

https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=11144;

Për çdo pyetje apo paqartësi për procedurën e ekuivalentimit mund të kontaktoni dhe në adresën licencat@infrastruktura.gov.al sektorin perkates ne institucionin kompetent per ekuivalentimin e licencave.